



FJALORTH RREPOJ

Rrjeti Evropian për Politikat në Orientimin gjatë gjithë jetës

Ky përkthim është iniciuar nga Ministria e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë në Kosovë, mbështetur nga Oranizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), projekti për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Fjalorthi është përkthyer nga versioni i dytë i Fjalorthit të botuar nga Rrjeti Evropian për politikat në Orientimin gjatë gjithë jetës (ELGPN Glossary, 2012 edituar nga Charles Jackson)

Verzioni i dytë

prill 2012



Contents

| | |
|---|---|
| Çasja në orientim (përfitimi nga orientimi)..... | 5 |
| Karrierë | 5 |
| Këshilltar karriere | 5 |
| Qendër karriere..... | 5 |
| Zgjedhje karriere | 5 |
| Këshillimi në karrierë | 5 |
| Këshilltar karriere..... | 5 |
| Vendimmarrja për karrierën | 6 |
| Orientim në karrierë | 6 |
| Sistemet e informimit për karrierën | 6 |
| Aftësitë për menaxhimin e karrierës..... | 6 |
| Menaxhimi i rastit | 6 |
| Instruktim/Coaching | 6 |
| Korniza e përbashkët e sigurimit të cilësisë | 6 |
| Mekanizmat e bashkëpunimit..... | 7 |
| Analizë kosto-përfitim..... | 7 |
| Shërbimet e orientimit në distancë | 7 |
| Braktisës..... | 7 |
| Person i larguar nga shkolla në mënyrë të parakohshme | 7 |
| Rezultatet ekonomike dhe sociale të orientimit..... | 7 |
| Orientim elektronik..... | 8 |
| Orientim arsimor..... | 8 |
| Efektiviteti | 8 |
| Punësueshmëria..... | 8 |
| Këshillimi/orientimi për punësim..... | 8 |
| Fuqizim..... | 8 |
| Orientim për ndërmarrësi | 8 |



| | |
|---|----|
| Politika dhe praktika e bazuar në të dhëna..... | 9 |
| Orientim | 9 |
| Këshilltar orientimi..... | 9 |
| Rezultatet e orientimit | 9 |
| Politika e orientimit..... | 9 |
| Shërbimet e orientimit..... | 9 |
| Sistemet e orientimit | 9 |
| Ndikimi | 9 |
| Tregues..... | 10 |
| Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)..... | 10 |
| Trajnim për të kërkuar punë | 10 |
| Kompetenca kyçe | 10 |
| Sistemet e informacionit të tregut të punës | 10 |
| Rezultatet e të nxënit nga orientimi | 10 |
| Orientimi gjatë gjithë jetës..... | 10 |
| Të nxënit gjatë gjithë jetës | 10 |
| Rezultat (cilësor) | 11 |
| Produkt (cilësor)..... | 11 |
| Masat/treguesit e performancës | 11 |
| Planifikimi personal i veprimit..... | 11 |
| Portofol | 11 |
| Profilizimi | 11 |
| Sigurimi i cilësisë | 11 |
| Kriteret e cilësisë | 11 |
| Treguesit e cilësisë | 12 |
| Standardi i cilësisë..... | 12 |
| Sistemi i cilësisë..... | 12 |
| Evidencat sasiore dhe cilësore | 12 |
| Tranzicioni | 12 |
| Njohuri për veten | 12 |



| | |
|--|----|
| Vet-menaxhimi i kompetencave | 12 |
| Vetëshërbim..... | 13 |
| Tranzicioni | 13 |
| Aftësitë kalimtare/transversale | 13 |
| Validimi i të nxënit joformal dhe informal | 13 |
| Orientim profesional | 13 |
| Përvojë pune | 13 |
| Praktikë pune | 14 |
| Të nxënit bazuar në punë..... | 14 |



Çasja në orientim (përfitimi nga orientimi)

Kushtet, rrethanat ose kërkesat (p.sh., kualifikimi, niveli arsimor, nevoja të posaçme, gjinia, mosha, etj.) që rregullojnë pranimin dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e orientimit dhe/ose të drejtën për përdorimin e shërbimeve apo programeve të orientimit.

Karrierë

Ndërveprimi i roleve të punës dhe i roleve të tjera jetësore përgjatë jetës së një personi, përfshirë mënyrën sesi ai ekuilibron punën e paguar e të papaguar, si dhe përfshirja e tij në të nxënë dhe arsimim.

Këshilltar karriere

Këshilltarët e karrierës ndihmojnë njerëzit të eksplorojnë, ndjekin dhe arrijnë objektivat e tyre të karrierës.

Këshilltarët/orientuesit e karrierës kanë, si rregull, formim profesional dhe zotërojnë kualifikim profesional.

Qendër karriere

Një vend ku njerëzit shkojnë për të marrë orientim në karrierë.

Zgjedhje karriere

Synimi i karrierës së një individi, bazuar në aftësitë vetanake, mundësitë, aspiratat dhe objektivat e tij të formësuara nga gjendja e tregut të punës dhe rrethanat e tij personale.

Procesi përmes të cilit zhvillohet dhe realizohet synimi i individit për karrierë.

Këshillimi në karrierë

Ndërveprimi midis një këshilltari karriere/orientimi dhe një individi.

Një proces individual ose në grup që thekson vetëdijësimin dhe të kuptuarit, dhe lehtëson zhvillimin e një drejtimi jete/punë të kënaqshëm e kuptimplotë, si bazë për të orientuar vendimet lidhur me të nxënë, punën dhe tranzicionin, si dhe për mënyrën sesi reagohet ndaj ndryshimit të mjediseve të punës dhe të të nxënë gjatë jetës.

Këshilltar karriere

Këshilltarët e karrierës i ndihmojnë njerëzit të eksplorojnë, ndjekin dhe arrijnë objektivat e karrierës.

Këshilltarët/orientuesit e karrierës kanë, si rregull, formim profesional dhe zotërojnë kualifikime profesionale të njohura.



Vendimmarrja për karrierën

Procesi i përzgjedhjes midis alternativave të veçanta të karrierës.

Orientim në karrierë

Një gamë veprimtarish që bën të mundur për qytetarët e çdo moshe dhe në çdo pikë të jetës së tyre të identifikojnë kapacitetet, kompetencat dhe interesat e tyre; të marrin vendime domethënëse për arsimin, aftësimin dhe profesionin dhe të administrojnë rrugët e tyre individuale jetësore drejt të nxënit, punës dhe mjediseve të tjera ku mësohen dhe/ose përdoren këto kapacitete dhe kompetenca.

Sistemet e informimit për karrierën

Sisteme, shpesh kompjuterike ose në internet por edhe të shtypura, të projektuara për të ndihmuar një individ ose grup në zgjedhjen e tij të karrierës, punësimit, profesionit ose vendit të punës duke mbledhur, organizuar dhe ofruar informacion mbi profile, profesione ose organizata të caktuara, përfshi përshkrimet e pagesës, kushteve, formimit, kualifikimeve dhe përvojës së kërkuar.

Sistemi i informacionit të karrierës përfshin edhe bazat e të dhënave që përdoren si burime informacioni.

Aftësitë për menaxhimin e karrierës

Një gamë kompetencash që ofrojnë mënyra të strukturuar për individët dhe grupet për të mbledhur, analizuar, sintetizuar dhe organizuar, informacionin personal, arsimor e profesional, si edhe aftësitë për të marrë dhe zbatuar vendime dhe tranzicione.

Ato janë aftësitë (shprehite) jetësore, të të nxënit, të aftësimit (formimit) dhe punësimit që njerëzit duhet të zhvillojnë për të menaxhuar (administruar) efektivisht karrierat e tyre.

Menaxhimi i rastit

Proces bashkëpunimi, i cili: shqyrton, planifikon, zbaton, bashkërendon, monitoron dhe vlerëson mundësitë dhe shërbimet e kërkuara për të përmbushur nevojat individuale shëndetësore, të kujdesit social, nevojat për arsimim dhe punësim, duke shfrytëzuar burimet e komunikimit dhe ato në dispozicion për nxitjen e rezultateve cilësore me kosto efektive.

Instruktim/Coaching

Proces i konceptuar për t'u përqendruar te zhvillimi i shprehive dhe ndryshimi i sjelljes për të përmirësuar rezultatet e punës. Instruktimi bëhet, zakonisht, në mënyrë individuale.

Korniza e përbashkët e sigurimit të cilësisë

Grup parimesh, udhëzimesh, kriteresh dhe mjetesh të përbashkëta të miratuara nga një grup në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar, me qëllim për të zhvilluar dhe siguruar cilësi në ofrimin e orientimit dhe në raport me kualifikimin e profesionistëve të orientimit.



Mekanizmat e bashkëpunimit

Proceset, sistemet apo strukturat organizative që përdoren për të lehtësuar bashkëpunimin midis njerëzve apo organizatave.

Analizë kosto-përfitim

Analizë krahasuese e kostove dhe përfitimeve të një shërbimi orientimi apo veprimtarie të caktuar orientimi – dhe e vlerës së këtij shërbimi ose kësaj veprimtarie – për të bërë zgjedhjen me më shumë përfitime financiare.

Shërbimet e orientimit në distancë

Shërbime orientimi të ofruara në largësi, për shembull, nëpërmjet telefonit, postës elektronike apo përmes internetit. Tipari kryesor është që klienti dhe punonjësi i orientimit nuk kanë kontakt të drejtpërdrejtë dhe, në shumë rrethana, nuk ka një punonjës orientimi të përfshirë drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimit të orientimit.

Braktisës

Braktisës është çdo njeri që është tërhequr nga një program arsimimi ose formimi pa e përfunduar atë.

Person i larguar nga shkolla në mënyrë të parakohshme

Personat e larguar nga shkolla në mënyrë të parakohshme janë ata individë nën moshën e detyrueshme për të përfunduar shkollën, të cilët janë tërhequr ose larguar nga programi arsimor ose i formimit pa e përfunduar atë.

Në kontekstin e BE-së, niveli i largimit të parakohshëm nga shkolla përcaktohet nga raporti i popullsisë së grupmoshës 18-24 vjeç vetëm me arsim të mesëm të ulët ose më pak se aq që nuk ndjek më arsimimin ose aftësimin (formimin). Personat e larguar nga shkolla në mënyrë të parakohshme janë, për rrjedhojë, ata persona të cilët kanë kryer vetëm arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të ulët apo një periudhë të shkurtër në arsimin e mesëm prej më pak se 2 vjetësh (ISCED 0, 1, 2 ose 3c të shkurtër) dhe këtu përfshihen edhe ata që kanë vetëm arsim paraprofesional ose profesional që nuk ka çuar në marrjen e një certificate të nivelit të mesëm të lartë.

Rezultatet ekonomike dhe sociale të orientimit

Orientimi ka rezultate ekonomike dhe sociale: veçanërisht, në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të arsimimit, aftësimin dhe tregut të punës nëpërmjet kontributit të tij për uljen e shkallës së braktisjes, duke parandaluar mospërputhjen e kualifikimeve, duke zgjatur kohën e qëndrimit në vendin e punës dhe duke rritur produktivitetin; si edhe në trajtimin e barazisë sociale e përfshirjes sociale.



Orientim elektronik

Këshillim apo orientim që ofrohet duke përdorur TIK-në dhe që mund të përfshijë drejtpërdrejt ose tërthorazi një këshilltar orientimi. Përdoret shpesh për të përshkruar ofrimin e informacionit apo përdorimin e mjeteve dhe ushtrimeve të vetëvlerësimit nëpërmjet internetit.

Këtu përfshihet orientimi i ofruar në rrjet, nëpërmjet telefonit ose faqes së internetit.

Orientim arsimor

Ndihmon personin të reflektojë mbi çështjet dhe përvojat vetjake të arsimimit dhe të kryejë zgjedhjet e duhura arsimore.

Efektiviteti

Shkalla në të cilën arrihen objektivat e një politike a një ndërhyrjeje, zakonisht, pa iu referuar kostove.

Punësueshmëria

Kombinimi i faktorëve që iu japin mundësi individëve të përparojnë apo të sigurojnë punësim, të qëndrojnë të punësuar dhe të ecin përpara gjatë karrierave të tyre.

Punësueshmëria e individëve varet nga (a) vetitë personale (përfshi përshtatshmërinë e njohurive dhe kualifikimeve); (b) mënyra sesi vetitë e këtyre personave paraqiten në tregun e punës; (c) nga konteksti mjedisor e social (stimujt dhe mundësitë e ofruara për të përditësuar dhe miratuar vlefshmërinë e njohurive dhe shprehive) dhe (d) nga konteksti ekonomik.

Këshillimi/orientimi për punësim

Këshillimi ose orientimi që përqendrohet në një ose më shumë prej fushave në vijim: vendimmarrje karriere/profesionale, rritje e kualifikimeve, kërkim për punë dhe ruajtje e punësimit. Veprimtaritë përfshijnë shqyrtimin, zhvillimin dhe zbatimin e një plan-veprimi, monitorimin vijues dhe vlerësimin.

Fuqizim

Procesi i inkurajimit të njerëzve për marrjen e përgjegjësisë më të mëdha për të kontrolluar jetët dhe karrierat e tyre duke krijuar besim më të madh në aftësitë e tyre.

Orientim për ndërmarrësi

Veprimet orientuese të projektuara për të ndihmuar individët që të shqyrtojnë sa të përshtatshëm janë për të filluar një ndërmarrje biznesi apo për t'u përfshirë në vetëpunësim, për të promovuar pro-aktivitet, ndërmarrësi dhe autonomi



Politika dhe praktika e bazuar në të dhëna

Përdorimi i ndërgjegjshëm, i shprehur dhe i matur i të dhënave aktuale të asaj çka funksionon më mirë dhe ka kosto më efektive, për të informuar politikat dhe praktikat e orientimit gjatë gjithë jetës.

Më në përgjithësi, çdo veprimtari, ndërhyrje ose mënyrë pune që është parashikuar në bazë të të dhënave që dëshmojnë efektivitetin e një qasjeje të caktuar (politike ose praktike) që është duke u zbatuar.

Orientim

Ndihmë për individët që të bëjnë zgjedhje mbi arsimin, aftësimin dhe punësimin.

Orientimi është një term ombrellë, i cili përfshin këshillimin, si edhe veprimtari të tilla si informimi, instruktimi, të mësuarit, vlerësimi dhe përkrahja.

Këshilltar orientimi

Individ i aftësuar që ofron orientim siç përcaktohet më sipër.

Këshilltarët e orientimit i ndihmojnë njerëzit të eksplorojnë, ndjekin dhe arrijnë objektivat e tyre të karrierës.

Rezultatet e orientimit

Orientimi ka rezultate ekonomike, sociale dhe të të nxënies dhe këto rezultate pasqyrojnë si ndikimin e tij te personi, ashtu edhe përfitime më të gjera për shoqërinë.

Politika e orientimit

Politika që përcakton dhe formëson gamën dhe nivelin e shërbimeve ekzistuese të orientimit, synimet dhe parimet e tyre, mënyrën e financimit të shërbimeve dhe kush kualifikohet t'i përdorë ato dhe në cilat rrethana.

Shërbimet e orientimit

Gama e shërbimeve të ofruara nga një ofrues i caktuar orientimi. Këto mund të jenë shërbime të projektuara për grupe të ndryshme klientësh ose mënyra të ndryshme të ofrimit të orientimit (p.sh. sy më sy, në internet, telefon, etj.)

Sistemet e orientimit

Mënyra se si është përcaktuar dhe organizuar ofrimi i shërbimeve të orientimit. Kjo mund të jetë qasje e zbatuar në një vend apo rajon të caktuar për organizimin e shërbimeve të orientimit ose një mënyrë e caktuar e ofrimit të orientimit, si në internet apo në distancë.

Ndikimi

Term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar efektet e një programi, politikë apo ndryshim social-ekonomik. Ndikimi mund të jetë pozitiv ose negativ, si edhe i parashikuar apo i paparashikuar.



Tregues

Faktor ose variabël sasiore ose cilësore që ofron një mjet të thjeshtë e të besueshëm për matjen e arritjeve, pasqyrimin e ndryshimeve që lidhen me një ndërhyrje ose për të ndihmuar në vlerësimin e performancës së një akteri zhvillues

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)

Teknologji që sigurojnë hedhjen, ruajtjen, tërheqjen, përpunimin, përcjelljen dhe shpërndarjen elektronike të informacionit.

Trajnim për të kërkuar punë

Trajnim i përcaktuar për të ndihmuar njerëzit në kërkimin për punë.

Kompetenca kyçe

Shuma e shprehive (shprehi bazë dhe shprehi të reja bazë) që duhen për të jetuar në shoqërinë bashkëkohore. Në rekomandimin lidhur me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës, Komisioni Evropian përcakton tetë kompetencat kryesore: komunikimi në gjuhën amtare; komunikimi në gjuhë të huaja; kompetencë në matematikë dhe kompetenca bazë në shkencë dhe teknologji; kompetencë digjitale; të mësosh si të nxësh; kompetenca shoqërore e civile; ndjenja e iniciativës dhe ndërmarrësisë; ndërgjegjësim dhe shprehje kulturore.

Sistemet e informacionit të tregut të punës

Sistemet, mekanizmat ose proceset për mbledhjen, organizimin dhe ofrimin e informacionit mbi situatën e tregut të punës dhe/ose profesionet dhe vendet e punës. Këtu përfshihet regjistrimi i ndryshimeve që ndodhin brenda tregut të punës, punësimit, vendeve të punës dhe profesioneve.

Rezultatet e të nxënit nga orientimi

Grupi i njohurive, shprehive dhe/ose kompetencave që individi përfiton dhe/ose është në gjendje t'i dëshmojë pas përfundimit të një veprimtarie orientimi ose nëpërmjet pjesëmarrjes në procesin e orientimit.

Orientimi gjatë gjithë jetës

Një gamë veprimtarishë që iu mundëson qytetarëve të çdo moshe dhe në çdo pikë të jetës së tyre të identifikojnë kapacitetet, kompetencat dhe interesat e tyre për të marrë vendime mbi arsimimin, aftësimin dhe profesionin dhe për të menaxhuar rrugën e tyre individuale në jetë lidhur me të nxënit, punën dhe mjedise të tjera në të cilat mësohen dhe/ose përdoren këto kapacitete dhe kompetenca.

Të nxënit gjatë gjithë jetës

E gjithë veprimtaria e të nxënit që ndërmerret gjatë jetës, që sjell si rezultat përmirësimin e dijeve, njohurive, shprehive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, shoqërore dhe/ose profesionale.



Rezultat (cilësor)

Ndryshim ose ndikim afatgjatë pozitiv ose negativ socio-ekonomik që ndodh drejtpërdrejt apo tërthorazi nga kontributi, veprimtaritë dhe produkti i ndërhyrjes.

Produkt (cilësor)

Rezultat konkret i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i një ndërhyrjeje.

Masat/treguesit e performancës

Të dhëna, zakonisht sasiore, që sigurojnë matjen e nivelit të arritjes së një individi, ekipi apo organizate, kundrejt të cilit mund të krahasohet niveli i të tjerëve.

Planifikimi personal i veprimit

Procesi i përcaktimit të hapave të nevojshme që duhet të ndërmarrë një individ dhe shërbimeve që atij/asaj mund t'i duhet të përdorë, me qëllim që të arrijë një objektivi të caktuar arsimor, profesional apo personal. Procesi mund të kryhet nga vetë individi, në bashkëpunim me dikë tjetër (p.sh., një këshilltar karriere) ose duke përdorur një formular/format tip apo instrument në internet.

Portofol

Portofoli është konceptuar për të qenë një regjistër i kompetencave (shprehi, njohuri dhe aftësi) dhe përvojave të një individi. Ai mund të përmbajë një listë të kualifikimeve formale ose të përfshijë shembuj të punës, si edhe të regjistrojë kurset e aftësimin, përvojën e punës dhe veprimtaritë joprofesionale të kryera nga individi.

Profilizimi

Procesi i mbledhjes së informacionit lidhur me një person, për të krijuar një profil që e përshkruan atë. Ai mund të përfshijë mbledhjen e një grupi standard informacionesh, mundësisht për të krahasuar njerëzit ose ndërtimin e një përshkrimi të vetëm të një personi.

Një qasje e ngjashme përdoret zakonisht edhe për profilizimin e vendeve të punës apo profesioneve dhe profili i punës ose ai profesional mund të përfshihen në një sistem informacioni për karrierën, për ta bërë më të lehtë krahasimin midis vendeve të punës dhe profesioneve.

Sigurimi i cilësisë

Veprimtaritë që përfshijnë planifikimin, zbatimin, vlerësimin, raportimin dhe përmirësimin e cilësisë, që zbatohen për të siguruar që veprimtaritë e orientimit (përmbajtja e programeve, konceptimi, vlerësimi dhe vlefshmëria e rezultateve, etj.) përmbushin kërkesat e cilësisë që presin palët e interesuara.

Kriteret e cilësisë

Standarde të pavarura për matjen e cilësisë së ofrimit ose shërbimeve të orientimit.



Kriteret e cilësisë janë treguesit e përdorur që tregojnë nëse shërbimi i orientimit apo veprimtaria e orientimit përmbushin standardet e cilësisë.

Treguesit e cilësisë

Shifër(a) ose raport(e) të përdorura si njësi matëse për të gjykuar dhe vlerësuar performancën e cilësisë.

Standardi i cilësisë

Parametrat teknike që janë të matshme dhe janë hartuar me mirëkuptim të miratuar nga një organizatë me përvojë të njohur e të përshtatshme në nivele rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare. Qëllimi i standardeve të cilësisë është përfitimi optimal i kontributit dhe/ose produktit të orientimit.

Standardi(et) që vendos një organizatë për të gjitha operacionet e veta kryesore të biznesit dhe që ndihmojnë për të bërë të qartë se çfarë pret organizata nga nëpunësit e vet për realizimin e këtyre operacioneve ose se çfarë mund të presë një klient kur përdor shërbimin.

Sistemi i cilësisë

Struktura organizative, procedurat, proceset dhe burimet e nevojshme për zbatimin e administrimit të cilësisë. Sistemi i cilësisë ofron kornizën për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ofruara dhe për kryerjen e duhur të sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të cilësisë.

Evidencat sasiore dhe cilësore

Për ofrimin e të dhënave sasiore përdoret informacion numerik, ndërsa të dhënat cilësore bazohen në vëzhgim e gjykim dhe merren me kuptimet. Zakonisht, të dhënat cilësore sigurohen nga ekspertët ose ata persona që, në bazë të aftësisë apo përvojës së tyre të punës, konsiderohet se kanë kualifikimin e mjaftueshëm për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

Tranzicioni

Procesi i zhvendosjes nga arsimi ose aftësimi në punësim, që mbulon periudhën në të cilën ndodh ndryshimi.

Njohuri për veten

Njohuria që ka individi për veten e tij/saj.

Vet-menaxhimi i kompetencave

Kur individi merr përgjegjësi për zhvillimin e kompetencave të veta. Ndonjëherë, kjo mund të përfshijë edhe marrjen e përgjegjësisë nga individi për regjistrimin apo hedhjen e kompetencave të tij/saj, për shembull, në një portofol.



Vetëshërbim

Një mënyrë e ofrimit të shërbimeve të orientimit, në të cilën përzgjedhja e shërbimeve dhe ndërhyrjet ose veprimtaritë e orientimit që do të përdoren varen nga vetë klienti.

Në disa raste, kjo bëhet nëpërmjet ofrimit të informacionit nga klienti për veten e tij/saj dhe, më pas, nëpërmjet drejtimit automatikisht të shërbimeve që mund të jenë të përshtatshme. Kjo qasje është veçanërisht e zakonshme kur ofrohen shërbimet në internet si pjesë e shërbimeve të orientimit ose në tërësi.

Tranzicioni

Procesi i kalimit nga një situatë arsimimi, punësimi apo aftësimi në një tjetër. Kjo përfshin edhe daljen nga tregu i punës, për shembull, në papunësi apo për t'u kujdesur për fëmijët dhe kthimin në punësim, arsim ose aftësim pas një periudhe kur personi nuk është në punë, arsim apo aftësim.

Aftësitë kalimtare/transversale

Aftësitë e zotëruara nga individët që janë të përshtatshme për punë dhe profesione të ndryshme nga ato që ata kanë aktualisht apo kanë pasur së fundmi. Këto shprehje mund të jenë fituar edhe nëpërmjet veprimtarive që nuk lidhen me punën apo përmes veprimtarive argëtuese ose pjesëmarrjes në arsim ose aftësim.

Më në përgjithësi, këto janë shprehje të cilat janë mësuar në një kontekst apo gjatë ballafaqimit me një situatë/problem të posaçëm dhe që mund të transferohen në një kontekst tjetër.

Validimi i të nxënësve joformal dhe informal

Procesi i konfirmimit nga një organ i autorizuar se një individ ka arritur rezultate në të nxënë në raport me një standard përkatës. Ai përbëhet nga katër faza të dallueshme: (1) identifikimi – nëpërmjet dialogut – i përvojave të caktuara që ka pasur individ, (2) dokumentimi – për t'i bërë të dukshme përvojat individuale – (3) një vlerësim formal i këtyre përvojave dhe (4) njohja që çon në certifikim, si p.sh., kualifikim i pjesshëm ose i plotë.

Orientim profesional

Ndihmë për individët për të bërë zgjedhje lidhur me arsimin, aftësimin dhe punësimin.

Ndonjëherë përdoret si sinonim i orientimit të karrierës ose orientimit.

Përvojë pune

Njohuritë, shprehjet dhe kompetencat e fituara nga individit gjatë jetës së punës.

Ky term përdoret edhe për të përshkruar periudha të shkurtra punësimi (që ndonjëherë ndodhin kur individit merr pjesë në një program përkatës arsimimi ose aftësimi) ose periudha pune si stazhier ose praktikant për të marrë përvojë në një profesion apo lloj pune të caktuar.



Praktikë pune

Mundësia për të marrë pjesë në veprimtari pune, me qëllim që të përfitojë përvojë dhe të zhvillojë aftësi të përshtatshme për punë dhe qëndrime për punë.

Të nxënit bazuar në punë

Marrja e njohurive dhe aftësive duke kryer dhe duke reflektuar mbi detyrat në një kontekst profesional, zakonisht në vendin e punës.